SONY

Udhëzime për përdorim

Si të instaloni softuerin e dhënë
Si të përdorni "WALKMAN"

NWZ-W273S/W274S

Qasje në manualin për përdorim (versionin e plotë).
http://rd1.sony.net/help/dmp/nwzw270s/en/

Mbi manualet
Ky udhëzim për përdorim përshkruan vetëm udhëzimet më të thjeshta të përdorimit dhe instalimin e softuerit të dhënë.
Për informacione në detaje dhe udhëzime për përdorim, shikoni Manualin (HTML dokument) të përfshirë në softuerin e dhënë pas instalimit.

* 4 4 7 6 0 3 9 1 2 * (1)

©2013 Sony Corporation
4-476-039-12(1)

Përmbajtja

Ju lutemi kontrolloni pjesët në paketimin.

- WALKMAN" (1)
- USB mbajtëse (1)

- Mbulesa për kufje (1 komplet)
- Mbulesa për not (1 komplet)
- Shiriti për përshtatje (1)
- Udhëzime për përdorim (ky manual)
- Përdorim i Walkman-it tuaj gjatë notit

Mbi sistemin operativ

Siguroni që SO është Windows XP*1 (Service Pack 3 ose më i ri), Windows Vista*2 (Service Pack 2 ose më i ri), Windows 7*2 (Service Pack 1 ose më i ri), ose Windows 8.
*1 Jo versionet e SO 64-bit.
*2 [Compatibility mode] për Windows XP nuk përmbahet.

Për Mac kompjuter, siguroni që SO është Mac OS X v10.6 ose më i ri. Nuk përmbahet nga SO tjera përveç atyre më lartë.

Lidhja e Walkman-it tuaj me USB mbajtësen (e dhënë) dhe karikimi i baterisë

Për të lidhur Walkman-in tuaj me kompjuter, aparat juaj duhet të jetë i lidhur mirë me USB mbajtësin.



1 Thani terminalet e Walkman (1) tuaj duke përdorur një leckë të thatë nëse duhet.

2 Lidhni Walkman me USB mbajtësin.

Siguroni që terminalet e Walkman (1) tuaj dhe USB mbajtësi (2) janë në kontakt me njëri-tjetrin.

3 Lidhni Walkman-in tuaj me kompjuter të kyçur me anë të USB mbajtësit.

- Nëse paraqitet një meny me zgjedhje, klikoni "Cancel". Fillon karikimi.
- Siguroni që OPE llamba në USB mbajtësin ndriçon në ngjyrë kuqe.



Shënime mbi karrikimin me anë të kompjuterit

- Karrikojeni baterinë kur OPR llamba ndriçon shpejtë.
- Gjatë karrikimit të baterisë, llamba tregon statusin e karrikimit të Walkman-it tuaj.
  Mund të shikoni statusin e OPR llambës nëpërmjet OPR dritares në USB mbajtësin.
  Ndriçon ngjyrë kuqe: Po karrikohet
  Shkyet: E karrikuar plotë ose nuk karrikohet
- Koha e karrikimit është rreth 1.5 orë.
  Kur Walkman-i juaj karrikohet plot, largojeni nga kompjuteri.
  Për Mac kompjuter, klikoni [WALKMAN] ikonën për nxjerrje në shiritin anash për të çlidhur Walkman-in tuaj.
- Nëse kompjuteri kalon në modi e kursimit të rrymës si Sleep ose modin e hibernacionit derisa Walkman-i juaj është lidhur me USB mbajtësin (i dhënë) Walkman mund të vazhdojë të merr rrymën nga bateria, duke e zbrazur.
- Kur përdorni Walkman-in tuaj për herën e parë, ose nëse nuk e keni përdorur
- Walkman-in për kohë të gjatë, mund të kalojnë disa minuta për të e njohur kompjuteri, madje edhe nëse ka filluar karrikimit (OPR llamba ndriçon ngjyrë kuqe). Kontrollojeni që kompjuteri e njeh Walkman-in tuaj menjëherë pasi që të e lidhni për kompjuteri për 5 minuta.

Si të instaloni softuerin e dhënë

Instalimi i WALKMAN Guide dhe Media Go (për Windows)

1 Lidheni Walkman-in ruaj me kompjuter të kyçur me USB mbajtësen (të dhënë).

2 Zgjidhni rendin më poshtë me kompjuterin.

- Windows 7 ose më të vjetër: Zgjidh [Start] – [Computer] ose [My Computer]
  – [WALKMAN] – [Storage Media] – [FOR_WINDOWS].
- Windows 8: Zgjidhni [Desktop] nga [Start screen] për të hapur [File Explorer]. Në listën [Computer], zgjidh [WALKMAN] – [Storage Media] [FOR_WINDOWS].

3 Klikoni dy herë [Setup.exe].

Paraqitet menyja për instalim.

- Kur të nisni [Setup.exe], [Setup.exe] skedari në [FOR_WINDOWS] dosjen Walkman është kopjuar në kompjuterin tuaj për kopje, dhe WALKMAN Guide dhe Media Go instalohen në kompjuterin tuaj.
- Nëse [Setup.exe] nuk fillon, kopjoni [Setup.exe] skedarin në desktop, dhe pastaj klikojeni dy herë.

4 Ndiqni udhëzimet në ekran.

Pasi që të përfundoje instalimi, WALKMAN Guide dhe Media Go ikonat paraqiten në desktopin e kompjuterit.
Help Guide është përfshirë në WALKMAN Guide.

Instalimi i Help Guide dhe softuerin e transferimit të përmbajtjes (për Mac)

1 Lidheni Walkman-in ruaj me kompjuter të kyçur me USB mbajtësen (të dhënë).

2 Në kompjuterin, zgjidh [WALKMAN] në shiritin anësor Finder dhe hapeni [FOR_MAC] dosjen.

3 Klikoni dy herë ikonën e instaluesit të softuerin të duhur:

Për të instaluar Help Guide:[Help_Guide_Installer_for_Mac]

Për të instaluar softuerin Content Transfer: [ContentTransfer.pkg]

4 Ndiqni udhëzimet në ekran.

Pasi që të përfundoje instalimi, aliasi (ikona) e softuerit të instaluar (Help Guide ose Content Transfer softueri) paraqitet në desktopin e kompjuterit tuaj.

Këshillë

- Para se të provoni të fshini softuerin nga Walkman-i juaj, kopjoni [FOR_MAC] dosjen në Mac kompjuterin tuaj si kopje nëse nevojitet.

Pjesët dhe kontrollet



1 **Pika prekëse**
2 **Shtrënguesi për qafë**
3 **Mbulesa për kufje**
4 **Seksioni i kufjeve**
5 **P.LIST (Playlist)/ SHUF (Shuffle) butoni**
6 **VOL +*1/– butoni**
7 **Terminalet**
8 **OPR (Operation) llamba**
9 **Kyçësja për kyçje**
10 **⏻ (Power) butoni**
11 **Butoni paraprak**
12 **Butoni vijues**
13 **RESET butoni**
14 **► II butoni*1**

*1 Ka pikë prekëse. Përdoreni për të lehtësuar rregullimin e zërit.

Mbi rregullimin e zërit (Vetëm për vendet/rajonet që zbatojnë Direktivat Evropiane)

Një alarm (sinjal) dhe shenja "Kontrolloni nivelin e zërit" shërbejnë për të mbrojtur veshët tuaj gjatë rritjes së nivelit të zërit mbi një nivel të caktuar*1 për herën e parë.
Mund të anuloni alarmin dhe paralajmërimin duke shtypur ndonjë buton.

Shënime

- Mund të rritni nivelin e zërit mi nivelin specifik*2 pas anulimit të alarmit dhe paralajmërimit.
- Pas paralajmërimit fillestar, alarmi dhe paralajmërimit përsëriten çdo 20 orë kumulative që niveli i zëri është vendosur mbi nivelin specifik*3; kur kjo ndodh, zëri ndryshohet ne nivelin [7] automatikisht.
- Nëse zëri është vendosur mbi nivelin specifik* dhe shkyçeni Walkman-in, niveli i zëri kthehet në nivelin specifik* automatikisht.

*1 Niveli specifik = [18]

Si të instaloni mbulesat e kufjeve

Për të degjuar cilësi më të mirë të zërit ose për të vendosur në veshë, përdorni madhësinë përkatëse ose rregulloni pozitën e mbulesave për dëgjim të këndshëm në veshin e djathtë dhe të majtë.
Mbulesa rezervë të kufjeve mund të gjeni nga distributori më i afërt Sony.

- Instaloni mbulesat në kufjet që maja e pjesës së brendshme të kufjeve **B** vendoset mirë në **A** pozitën në projektimin e kufjeve.
- Siguroni që mbulesat të vendosen drejtë, jo në kënd, për parandaluar mbulesat të dalin dhe të mbesin në veshët tuaj.

Si të kyçni rrymën dhe të mbani Walkman-in në veshë

1 Kontralloni anët e majtë (L) dhe të djathtë (R) të Walkman.

2 Rrëshqitni POWER kyçësin në anën e majtë (L) për të kyçur Walkman.

3 Shtyp dhe mbaj ⏻ (Power) butonin që gjendet në pjesën e djathtë (R) për rreth 3 sekonda për të kyçur Walkman-in tuaj.



4 Vareni shtrëngueshin për qafë në majë të veshëve dhe pas kokës.

5 Vendosni Walkman-in tuaj në veshë.

6 Përshtateni Walkman-in tuaj për dëgjim të këndshëm.



Shënime

• Nëse Walkman-i juaj nuk është komfort, ndryshoni mbulesat. Shikoni pjesën "Si të instaloni mbulesat e kufjeve" .

Parandalimi i Walkman-it tuaj që rastësisht të del nga veshët

Vendosni shtrëngueshin për qafë të dhënë para se të vendoni Walkman-in tuaj në veshë.



Shënime

• Pasi të vendosni Walkman-in tuaj me shtrëngueshin e vendosur, rregulloni pozitën e shtrëngueshit në vend që të jetë i rehatshëm.

Këshillë

• Nëse Walkman-i juaj del nga veshët gjatë notit, stabilizoni shiritin duke përdorur shiritin e syzeve për notim.

Largimi Walkman-it

Ngadalë lëvizni Walkman-in lartë dhe postë për e nxjerrë nga veshët.

Shënime

• Largimi i Walkman-it përnjëherë kur mbulesat janë vendosur mirë në veshët mund të shkaktojë dëmtime të veshit ose timpanit ose mbulesat mund të mbesin brenda veshëve.

Dëgjimi i muzikës



Kyçja dhe shkyçja e aparatit

Shtypni dhe mbani ⏻ (Power) butonin për rreth 3 sekonda për të kyçurose shkyçur Walkman-in. Pasi të shkyçni, siguroni që të rrëshqitni kyçësen për kyçje në për të mbyllur ⏻ (Power) butonin.

Shënime

• Kur të përdorni Walkman-in tuaj, siguroni që të rrëshqitni kyçësen për kyçje ⏻(Power) për të shmangur kyçjen e rastësishme të aparatit.

Dëgjimi i këngëve

Shtypni ⏯ butonin.

Pauzimi i dëgjimit

Shtypni ⏯ butonin.

Kërcimi në këngën vijuese/paraprake

Shtypni butonin vijues ose paraprak.

Mënjanimi i problemeve

Nëse Walkman-i juaj nuk funksionon mirë, provoni hapat më poshtë për të zgjedhur çështjen.

1 Gjeni simptomat e çështjes në "Mënjanimin e problemeve" në Help Guide (HTML dokument) dhe provoni ndonjërën prej veprimeve më poshtë.

Për detaje mbi mënjanimin e problemeve, shikoni edhe tabelat në të djathtë.

2 Shtypni RESET butonin me laps ose me kapëse për letra, etj.

Kur të rinisni Walkman-in tuaj, ju lutemi të keni kujdes edhe këto më poshtë.

- Walkman-i juaj nuk është lidhur me kompjuterin.
- Walkman-i juaj nuk lëshon muzikë



Simptoma	Shkaku/Zgjidhja
Kompjuteri juaj nuk e njeh Walkman-in tuaj.	• Walkman-i juaj nuk është lidhur me kompjuterin tuaj me anë të USB mbajtësit (i dhënë). → Vendosni Walkman-in tuaj në USB mbajtësen mirë dhe fort. Karrikimi do të filloje (OPR llamba ndriçon kuqimadje edhe nëse lidhja nuk është bërë mirë, por ka mundësi që kompjuteri mos të ketë njohur Walkman-in. Në këtë rast, largoni Walkman-in nga USB mbajtësi dhe pastaj lidheni sërish USB mbajtësin. • Bateria e mbetur është tepër e ulët ose e pamjaftueshme. → Rikarrikojeni baterinë. Kur të përdorni Walkman-in tuaj për herën e parë ose nuk e keni përdorur për një kohë të gjatë, mund të kalojë disa minuta për të njohur nga kompjuteri, edhe nëse karrikimi vetëm më ka filluar (OPR llamba ndriçon ngjyrë portokalli). Kontrolloni që kompjuteri njeh Walkman-in pasi që të lidhni për kompjuteri për rreth 5 minuta.

Simptoma	Shkaku/Zgjidhja
Kompjuteri juaj nuk e njeh Walkman-in tuaj.	• Kompjuteri përdor softuer tjetër nga ajo që përdoret për transferimin. → Largoni USB kordonin (i dhënë), pritni për disa minuta dhe lidheni sërish. Nëse problemi vazhdon, largojeni USB kordonin (i dhënë), rifillojeni kompjuterin dhe pastaj lidheni sërish USB kordonin (i dhënë).
Kur klikohen dy herë [Setup.exe] për të instaluar softuerin e dhënë në Windows kompjuter, [Setup.exe] nuk niset dhe hapet dritarja me cilësime.	• Instaloni softuerin e dhënë pas instalimit të Windows Media Player 11 ose më të ri në Windows kompjuterin. Për detaje mbi Windows Media Player, shikoni ueb faqen më poshtë: http://support.microsoft.com/
Gjatë dëgjimit të Këngës, kënga tjetër përnjëherë fillon	• Walkman-i juaj mund të bëjë ZAPPIN Për detaje, shikoni manualin.

Paralajmërime

Për dëgjueset brenda veshit

Mbulesat e kufjeve mbulojnë veshët tuaj. Andaj, keni kujdes që ka rrezik të dëmtimit të veshëve ose tupanit të veshit nga shtypja e madhe nga mbulesat ose mbulesat mund të largohen nga veshët. Pas përdorimit, kujdes që të largoni mbulesat me lehtësi dhe ngadalë.

Për kufjet

- Mos lëshoni njësinë në zë të lartë sepse dëgjimi më afatgjatë me zë të lartë mund të ndikojë mbi të dëgjuarit.
- Në zë të lartë, zërat e jashtme mund mos të dëgjohen. Mos dëgjoni me njësinë në situata ku dëgjimi nuk duhet të pengohet, për shembull gjatë vozitjes ose drejtimit të biçikletës.
- Meqë kufjet e dhëna janë të dizajnit të hapur, zëri kalon nëpër kufjet. Mbani mend që mos të pengoni personave që janë afër juve.

Informacione mbi ligjet dhe shenjat dalluese

Shikoni Udhëzuesin për Ndihmë (HTML dokument).

Shënim i pronarit

Modeli dhe numrat serik gjenden mbrapa aparatit. Shënoni në vendin e dhënë më poshtë. Shikoni këto numra çdoherë kur të lajmëroni Sony distributorin në lidhje me produktin.

Nr. i modelit_____
Nr. serik_____

Informacionet më të reja

Nëse keni pyetje ose probleme me këtë produkt, ose dëshironi informacione lidhur me aksesorët kompatibile të këtij produkti, vizitoni ueb faqet më poshtë.
Për konsumatorët në ShBA:
http://www.sony.com/walkmansupport
Për konsumatorët në Kanada:
http://www.sony.ca/ElectronicsSupport/ Për konsumatorët në Amerikën Latine:
http://www.sony-latin.com/index.crp
Për konsumatorët në Evropë:
http://support.sony-europe.com/dna/wm/ Për konsumatorët në Azi, Oqeani dhe Afrikë:
Anglisht: http://www.sony-asia.com/support
Kore: http://scs.sony.co.kr/walkman/
Kinezishte e thjeshtë: http://service.sony.com.cn/KB/
Kinezishte tradicionale: http://service.sony.com.tw/
Për konsumatorët që kanë bërë modelet tejoqeanike:
http://www.sony.co.jp/overseas/support/